



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 020/04-6962 dt. 06.02 2020


Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenin 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit i cili ndodhet në objektin e vjetër të komunës së Drenasit

- I.** Formohet Komisioni për evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit i cili ndodhet në objektin e vjetër të komunës së Drenasit në këtë përbërje:
1. Armend Hajdini, (kryetar),
 2. Bujar Plakiqi, (anëtar),
 3. Ksamil Ramadani, (anëtar),
 4. Arben Shala, (anëtar),
 5. Rrahim Hasi, (anëtar).
- II.** Ky komision ka për obligim që të bëjë evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit i cili ndodhet në objektin e vjetër të komunës së Drenasit, si dhe ta bëjë skanimin e të gjitha dokumenteve të rëndësishme, të cilat pastaj duhet të dorëzohet të drejtoritë përkatëse.

- III.** Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
- IV.** Komisioni i lartcekur punën e tyre duhet ta kryej me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim, dhe të njëjtën ta përfundoj në afat sa me të shkurtër.
- V.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

 Kryetari i Komunës

Kamiz Lladrovi

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të Komisionit;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.